

# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**GLOBAL STRATEGIC INITIATIVES SHPK**

**KREU I**

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është **GLOBAL STRATEGIC INITIATIVES SHPK**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **GLOBAL STRATEGIC INITIATIVES shpk**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **GLOBAL STRATEGIC INITIATIVES shpk**, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane ne adresen: **Rruga "Kongresi Manastirit", Pallati afer me Mjekesine Ligjore, Ap 5.** Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

(2) Adresa e Shoqërisë për qëllimin e komunikimit elektronik është si vijon:

- a. Tel : 355 42 450250
- b. Email: info@gsi.al
- c. Web: www.gsi.al

Neni 4

Kohezgjatja dhe objekti

Z.R

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te jetë :

Aktivitet ne fushen e konsulences, te perqatise dhe hartoje projekte ne fushen laboratorike etj, studime te fizibilitetit, Studime tregu Kombetare dhe Nderkombetare, Hartimi i strategjive te biznesit per industri te ndryshme, Hartimi i strategjive te biznesit per industri te ndryshme. Kryerja e analizave dhe vleresimeve te biznesit per industri te ndryshme, keshillime, studime tregu, hartime plan biznesi. Modelim bizneseve te reja dhe rimodelim i bizneseve sikurse dhe Vleresime risku dhe keshillime.

Zhvillim ose ndermjetesim i trajnimeve ne fusha te ndryshme ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Konsulence ne fushen e menaxhimit dhe marketingut per kompani apo persona qe operojne ne fushen laboratorike.

Shoqeria do te kryeje marketingun e shoqerive te huaja dhe vendase duke perfshire: Studime tregu, ndertime biznes planesh, fushata marketingu, fushata sensibilizuese dhe promovuese, konsulenca te ndryshme etj si brenda dhe jashtë Republikës se Shqiperise duke zbatuar ligjet e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti. Shoqeria do te krijoje ideoje dhe implementoje fushata marketing per nevojen e saj ose paleve te treta. Shoqeria do te ndermjetesoje krijimin e mardhenieve midis shoqerive te huaja dhe atyre shqiptare per promovimin e kulturave dhe bizneseve te ndryshme ne Shqiperi si dhe anasjelltas. Konsulence per pajisjet mjeksore per spitalet dhe sherbime te tjera te kujdesit shendetor.

---

## KREU II KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie. **Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jetë 100 000 leke (njeqind mijë).**

Ortaku themelues i Shoqërisë Janis Karathano, ka ne zoterim **100%** te kapitalit te shoqerise, ose 1 (nje) kuote me vleren e 100 000 (njeqind mijë) lekeve.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit

JK

themeltar për kontributet nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Nëasnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përrpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjeter.

Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë.

Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqërisë dhe secilit prej ortakëve. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të nenit 11 të këtij ligji.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

### Organit Vendimmarres

I.K

Asambleja e Përgjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Përgjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Neni 9

#### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vedin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

#### Kuorumi

- a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të

votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11  
Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me vendim te ortakut te vetem për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me vendim te ortakut te vetem, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator.

*Administrator i shoqerise eshte z. Janis Karathano, i biri i Thoma-it, lindur me 17.04.1951, ne Haskove, Gjirokaster dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. 030972113, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per një periudhe 5 vjecare me te drejte riparteritje.*

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.


Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 13

J.K

Kompetencat



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 14

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

J.K

Pasojet e marrëveshjeve të pëmiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblesnjë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) ti kthejë ortakëve kontributet;
- b) ti paguajë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) te shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) te lejojë që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 15

#### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 16

#### Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Pergjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.

Mbledhja e Pergjithshme vendos rreth shperndarjes se dividenteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji, ne raport me kuotat e zoteraura nga secili prej ortakeve.

Neni 17


#### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruar prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakeve.

JK

Ne perfundim të kontrollit eksperi kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilanci finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe kane.

Neni 18



Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakeve, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante, krijimin e Rezerves Ligjore. Rezerva e Ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te një shume te barabarte me 5% te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit finanziar, deri sa te arrihet një shume e barabarte me 10% te kapitalit themeltar te Shoqerisë.

Neni 19

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 20

#### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim te asamblesë se përgjithshme;
- me hapjen e procedurave te falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit";
- me vendim te gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 21

#### Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria, me anë te bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqerie ekzistuese ose një shoqerie te re që ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me anë te ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive te tjera

ekzistuese ose disa shoqërije të reja.

Ortakët e shoqërise që bëjnë kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojnë pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim më para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës Nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj t e shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 22

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKR.

Neni 23

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 24

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesish ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten ceshtja mund të behet objekt konflikti gjyqsor ne Gjykatës e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 25

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 26

#### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si

T.K

dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 27

Dispozita perfundimtare



Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise Tregtare **GLOBAL STRATEGIC INITIATIVES** shpk, dhe nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të cilit vertetohet nga une Noteri.

ORTAKU THEMELUES

NOTERI

Adriana Solis